




**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 31.03.2014**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.03.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 150, të datës 12.03.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:


**V E N D I M**

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në komunën e Fushë-Kosovës, për vitin 2013, në shumë të përgjithshme prej 6,835,393.94€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër njësitë buxhetore ekonomike është si vijon:
  - 2.1 Në Administratë buxheti i shpenzuar është 3,240,007.83€,
  - 2.2 Në Arsim buxheti i shpenzuar është 2,513,291.14€,
  - 2.3 Në Shëndetësi buxheti i shpenzuar është 1,052,216.67€ dhe
  - 2.4 Në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim buxheti i shpenzuar është 29,878.30€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FBP dhe Arkivës.**

**Kryesues i Kuvendit të Komunës**  
**Mr. Fadil Krasniqi**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 03.04.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.03.2014, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 151, të datës 12.03.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë, përmes Kryetarit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (g), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (f), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi që Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, Nr. 63, e datës 16.05.2013, pa ndryshime, zbatohet edhe gjatë vitit 2014, në territorin e komunës së Fushë-Kosovës.
2. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.**

**Kryesues i Kuvendit të Komunës**

**Mr. Fadil Krasniqi**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 03.04.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.03.2014, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 79, të datës 10.02.2014, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 17, shkronja (o), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (i), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (k), nenin 27, shkronja (gj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**


1. Formohet Komisioni Komunal për emërtimin, riemërtimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike, në territorin e komunës së Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2013/2017.
2. Komisioni Komunal përbëhet prej nëntë anëtarëve:
  - 2.1 . Maliq Berisha - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis;
  - 2.2 . Milaim Berjani - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LDK-së;
  - 2.3 . Aida Alimi - Anëtare e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e PDK-së;
  - 2.4 . Trandolina Duli - Anëtare e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e LVV-së;
  - 2.5 . Hasan Krasniqi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i AAK-së;
  - 2.6 . Miroslav Veličković - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i GIS-it;
  - 2.7 . Esad Kodra - Përfaqësues i PD-së;
  - 2.8 . Hasan Ismajli - Përfaqësues i AKR-së;
  - 2.9 . Lindita Dervisholli-Prebreza - Njësia për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Mundësi të Barabarta;
3. Detyrë dhe Përgjegjësi e Komisionit, është shqyrtimi i kërkesave për emërtimin, riemërtimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.**

**Kryesues i Kuvendit të Komunës**

**Mr. Fadil Krasniqi**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 03.04.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.03.2014, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 43, të datës 11.02.2014, paraqitur nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, përmes Kryetarit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 3, paragrafi 1, pika 1.3, nenin 4, nenin 5, nenin 7, nenin 8, të 'Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës' Nr. 04/L-144 (Gazeta Zyrtare Nr. 35/2012), nenin 2, nenin 4 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Nr. 23/2013, nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

1. Për fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vite, Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514036-01342-0, në sipërfaqe prej 1959m<sup>2</sup> në vendin e quajtur 'Glog Materialni Rov/Glog', e evidentuar në Fletën Poseduese me numër të certifikatës Nr. 25-1457, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, përmes procedurës së ankandit publik.
2. Për dhënien në shfrytëzim të Ngastrës Kadastrale, të cekur në pikën një (1) të vendimit, formohet Komisioni për vlerësimin e ofertave në përbërje prej shtatë anëtarëve:
  - 2.1 . Sabri Rexhepi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LDK-së;
  - 2.2 . Sokol Duraku - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i PDK-së;
  - 2.3 . Elmi Shabani - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LVV-së;
  - 2.4 . Violeta Xhigoli - Zyrtare e Prokurimit;
  - 2.5 . Ejup Qyqalla - Shef për Shërbime Publike;
  - 2.6 . Milanka Bojkoviç - Zyrtare e Lartë për Financa;
  - 2.7 . Rexhep Gojnovci - Përfaqësues i Shoqërisë Civile.
3. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit është që të bëjë, vlerësimin e ofertave dhe ofertat ekonomikisht më të favorshme, në pajtim me kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, i propozon në Kuvendin e Komunës për miratim.

4. Kryerja e detyrave për zhvillimin e procedurave për ankandin public, dhe procedurave tjera, është në kompetencë të Drejtorisë për Administratë - Zyrës së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë për Ploanifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.
5. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë për Administratë, Drejtorisë për PUKGJ dhe Arkivës.**


**Kryesues i Kuvendit të Komunës**  
**Mr. Fadil Krasniqi**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 17.04.2014**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.03.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 153, të datës 12.03.2014, paraqitur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 13, paragrafi 3 i Rregullores për ndarjen e subvencioneve, Nr. 83 të datës 14.06.2013 mori:

**V E N D I M**

1. Lejohen mjetet financiare, në shumë prej 8000€, për Nuriye Avdiu, me destinim për të ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve shëndetësore nga sëmundja me Dg. Maxillectomia totalis Carcinoma myoepitheliale (maksila I tumor).
2. Është në kompetencë të Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë që të sigurojë mjetet financiare nga buxheti i komunës sipas pikës (1) një të vendimit.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Drejtorisë për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale dhe Drejtorisë për Financa, Buxhet e Pronë.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për SHMS, Drejtorisë për FBP dhe Arkivës.**

**Kryesues i Kuvendit të Komunës**  
**Mr. Fadil Krasniqi**

